

**VENDIM**  
**Nr.287, datë 14.4.2011**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR  
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E FUSHATËS SË  
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE, MË 8 MAJ 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, t’i shtohet një fond prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, për financimin e fushatës së subjekteve zgjedhore për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, më 8 maj 2011.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**